



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 18

Prishtinë, më 13. 07. 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Fatmir Rexhepi – kryetar, Nerxhivane Dauti, Ibrahim Makolli, Ibrahim Selmani, Drita Maliqi, Luljeta Shehu dhe Shpresa Murati.

Munguan: Hajredin Hyseni dhe Danush Ademi

Pjesëmarrës të tjerë: Nexhat Shatri – ZPRK, Ardi Shita – OSBE, Sebahate Shala – anëtare e Këshillit Organizativ në rastin „Kiçina”, Besnik Ramadani – KDI dhe Elita Vokshi – OSBE.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi

Mbledhjen e drejtoi: Fatmir Rexhepi - kryetar.

Fatmir Rexhepi konstatoi se në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 30. 6. 2010,
3. Shqyrtimi i rekomandimit të Kryesisë së Kuvendit lidhur me rastin “Kiçina”,
4. Shqyrtimi i kërkesës së disa ankueseve lidhur me moszbatimin e vendimit të KPMK-së,
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 30. 6. 2010

Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 30. 06. 2010 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i rekomandimit të Kryesisë së Kuvendit lidhur me rastin “Kiçina”

Fatmir Rexhepi –tha se Kryesia e Kuvendit e shqyrtoi shkresën e Këshilli organizativ për drejtësi për rastin “Kiçina”qe kanë kërkuar të mbahet seancë e jashtëzakonshme . Mirë po , në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk është kompetente për thirrjen e saj dhe ia procedoi për shqyrtim Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Metutje shtoi se Kryesia e Kuvendit, është i vetmi autoritet për ta vënë në rend dite këtë çështje dhe ta vlerësojë se a do të hyjë për shqyrtim në seancë apo jo. Meqë kjo nuk është kompetencë e Komisionit, por e Kryesisë së Kuvendit, nëse vendos ta ketë në rend të ditës për shqyrtim, Komisioni do ta ketë për detyrë ta përgatitë pjesën e vet. Po ashtu ,nuk duhet të ketë ndërhyrje në punën e gjyqësorit. Për këtë hap debatin.

Drita Maliqi - E mbështes mendimin e kryetarit qe ta përkrahim rekomandimin e mëhershëm të Komisionit. Janë mbledhur 48875 nënshkrime. Kushtetuta lejon që një çështje e tillë të debatohet ne Kuvend, sepse kjo u përket të drejtave të njeriut.

Ibrahim Selmani - U pajtua diskutimin e parafolësës. Lidhur me këtë pikë ia kërkoj mendimin Nerxhivane Dautit. Në fund shtoi se ishte për të diskutuar, jo vetëm për këtë rast, por edhe për disa raste të tjera, që kanë të bëjnë me drejtësinë. Pra kemi të drejt të trajtojmë drejt fatin e njerëzve dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Ishte i mendimit që të futej pikë e rendit të ditës në seancë plenare.

Ibrahim Makolli - Mendon se përderisa peticioni i plotëson kushtet e parapara me Kushtetutën e Kosovës, juridikisht mund të shqyrtohet në Kuvend. Komisioni për të Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore Persona te Pagjetur dhe Peticione nuk ka kapacitete për të vërtetuar se gjyqi është bazuar në dëshmi të rrejshme, për ta sajuar akuzën etj. Pra, nuk si Komisioni mund t’i vërtetojë faktet, deklaratat e dëshmitarëve për mbrojtje të rrejshme, se a ka shkelje të të drejtave të njeriut në rastin Kiçina, siç pretendohet nga ana e nënshkruesve të peticionit. Prandaj si mundësi për te ardhur te një përfundim, nëse konstatohet se ka shkelje të të drejtave të njeriut në procesin gjyqësor Kiçina dhe ne proceset e tjera mbetet të hulumtohen të gjitha materialet për lëndë të caktuara. Ishte i mendimit se Kuvendi i Kosovës kishte nevojë të debatojë për sistemin e drejtësisë në Kosovë e jo të merret vetëm me raste të veçanta. Kuvendi duhet të debatojë për çështjet që i shqetësojnë qytetarët e vendit. Komisioni duhet t’ia rekomandojë Kryesisë së Kuvendit ta shqyrtojë peticionin, sepse ligjërisht i plotëson kriteret e parapara me Kushtetutë. Në të theksohen ankesa të qytetarëve për shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e gjyqësorit. Dyshime dhe shqetësimet e qytetareve i vërteton edhe raporti i Avokatit te Popullit për vitin 2009. Prandaj Kuvendi i Kosovës do të duhej në një seancë te veçante të debatojë për sistemin e drejtësisë në Kosove për të drejtat e njeriut.

Pas një debati Komisioni njëzëri vendosi që Kryesisë së Kuvendit t’ia procedojë këtë:

R e k o m a n d i m

Komisioni vlerëson se peticioni i plotëson të gjitha kushtet formalo-juridike, prandaj i rekomandon Kryesisë së Kuvendit të vërë ne rend dite për shqyrtim në një nga seancat plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i kërkesës së disa ankueseve lidhur me moszbatimin e vendimit të KPMK-së

Nerxhivane Dauti, ne cilësi të raportueses, e njoftoi Komisionin për përmbajtjen e ankesave të M.B., H.I., J.J dhe N.D. nga Drenasi në të cilat kërkohet zbatimi i Vendimit të plotfuqishëm të KPMK-së, nr. 02/169/2007. Gjithashtu theksoi se institucionet e Kosovës nuk po i zbatojnë vendimet e KPMK-së. Kushtetuta KPMK-në në nenin 101.2 e konsideron kategori kushtetuese. Moszbatimi i vendimit të KPMK-së është në kundërshtim me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore, si akt i zbatueshëm drejtpërdrejt në Kushtetutën e Kosovës. Komisioni, lidhur me këto vendim e propozoi këtë

Rekomandim

- Komisioni u rekomandon institucioneve të rëndësishme të marrin masa të menjëhershme për ekzekutimin e Vendimit të KPMK-02/169/2007, të 8. 5. 2007.
- Komisioni i sugjeron institucionit të Avokatit të Popullit, në pajtim me nenin 4.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006 për institucionin e Avokatit të Popullit dhe me nenin 132.3 të Kushtetutës së Kosovës, që Komisioni të njoftohet për veprimet që merren për zbatimin e vendimit.

Ibrahim Makolli - Propozoi të plotësohet lista e atyre që janë ankuar për moszbatimin e vendimeve të KPMK-së dhe të njoftohet Kryetari i Kuvendit të Kosovës si autoritet i cili duhet ta njoftojë zyrtarisht Kryeministrin e Qeverisë së Kosovës për moszbatimin e vendimeve të KPMK-së. Deputetët: Drita Maliqi, Fatmir Rexhepi dhe Nerxhivane Dauti u pajtuan me propozimin e parafolësit. Pas një debati konstruktiv Komisioni njëzëri vendosi që në mbledhjen e radhës të shqyrtohet regjistri i vendimeve të pazbatuara nga institucionet e Kosovës.

5. Te ndryshme

Kryetari tha se në këtë pikë janë për t'u shqyrtuar 4 raporte të projektligjeve me amendamente të propozuara nga komisionet funksionale për shqyrtim në aspektin e të drejtave të njeriut, si vijon:

- Shqyrtimi i amendamenteve në Projektligjin për administratën shtetërore të Republikës të Komisionit Funkcional të Kosovës nga aspekti i të drejtave të njeriut,
- Shqyrtimi i amendamenteve në Projektligjin për konfliktet administrative të Komisionit funksional nga aspekti i të drejtave të njeriut,

- Shqyrtimi i Raportit me amendamentet për Projektligjin për komunitetin rezervë të Forcës së Sigurisë të Kosovës të Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i të drejtave të njeriut,
- Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për gjykatat të Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i të drejtave të njeriut.

Komisioni njëzëri i miratoi projektligjet dhe vendosi për këto projektligje ta nxjerrë këtë

R e k o m a n d i m

Komisioni konstaton se Projektligji për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, të Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i të drejtave të njeriut, nuk i cenon parimet e përgjithshme dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për projektligjet në vijim:

Komisioni konstaton se amendamentet në Projektligjin për konfliktet administrative të Komisionit funksional, nga aspekti i të drejtave të njeriut, nuk i cenojnë parimet e përgjithshme dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për projektligjet në vijim:

Komisioni konstaton se amendamentet për Projektligjin për komunitetin rezervë të Forcës së Sigurisë të Kosovës të Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i të drejtave të njeriut, nuk i cenojnë parimet e përgjithshme dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për projektligjet në vijim:

Komisioni konstaton se propozimamendamentet në Projektligjin për Gjykatat të Komisionit FunkSIONAL, nga aspekti i të drejtave të njeriut, nuk i cenojnë parimet e përgjithshme dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për projektligjet në vijim:

Komisioni konstatoi se amendamentet e Projektligjit për konfliktet administrative të Komisionit FunkSIONAL nuk i cenojnë parimet e përgjithshme dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, por u sugjeron Komisionit FunkSIONAL dhe Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi t'i harmonizojë amendamentet aty ku ka mosharmonizim.

Në bazë të neneve 57, 62 dhe 67 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni do t'i nxjerrë raportet me rekomandime në aspektin e të drejtave të njeriut dhe t'ia paraqesë Komisioni FunkSIONAL dhe Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 30.

Kryetari i Komisionit

Fatmir Rexhepi